



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa nr. 160/5, datë 28.03.2023 “ Njoftim përqendrimi në kuadër të njoftimit të përfimit të kontrollit të Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited mbi Khidrat Renewable Energy Private Limited”.

Sipas dokumentit “Marrëveshje për transferimin e kuotave”, palët janë:

Pala blerëse: Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited është një shoqëri private, e themeluar sipas legjislacionit indian, me objekt aktiviteti: Gjenerimi, grumbullimi, shitja dhe furnizimi me energji të Pastër dhe të Gjelbër nga burime energjie jokonvecionale dhe të reja si Bio-masa, Mbeturinat, Hidro, Gjeotermale, Era, Diellore etj për të ngritur, operuar, mirëmbajtur stacionet e prodhimit të energjisë; për të furnizuar, shitur dhe tregtuar energji te Qeveritë, Shoqëritë, Njësitë Industriale etj.

Shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited zotërohet 100% nga Statkraft IH Holding AS, pjesë e Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëria target: Khidrat Renewable Energy Private Limited është një shoqëri private, e angazhuar në ndërtimin, operimin dhe furnizimin me energji nga dielli për klientët.

Shoqëria target nuk është prezente dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri. Aktiviteti i saj fokusohet në ndërtimin e projektit të energjisë diellore në rrethin Bikaner dhe Rajasthan (një shtet në Indinë Perëndimore).

Pala shitëse: Enel Green Power India Private Limited, është një shoqëri, e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, e cila zotëron Khidrat Renewable Energy Private Limited.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.